O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;

-
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
 4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia (muaj)	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Shpenzime pastrimi, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera për zyra	12 muaj			
2.					
3.					
4.					
				Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nëshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Shpenzime pastrimi, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera për zyra”

Afatet e ekzekutimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Nr.	Lloji i Shërbimit	Frekuenca e pastrimit
1	Pastrimi, larja e dyshemesë në të gjithë ambientin e brendshëm	Çdo ditë
2	Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe hapësira të përbashkëta).	Çdo ditë
3	Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.	Çdo ditë
4	Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.	Çdo ditë
5	Pastrimi i WC-ve, aksesoreve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
6	Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër për duart dhe sapun i lëngshëm për larje të duarve).	Çdo ditë
7	Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
8	Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobileve brenda tyre.	Çdo ditë
9	Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e ballkoneve dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, arkiva, salla mbledhjeve, kuzhina etj).	Një herë në muaj
10	Pastrimi i ballkoneve, dyshemenë dhe parruket.	Një herë në javë
11	Pastrimi i Arkivës.	Një herë në muaj
12	Pastrimi i xhamave brenda dhe jashtë.	Një herë në muaj
13	Pastrimi i ambientit në Dhomën e Serverit.	Një herë në muaj
14	Vaditja, prashitja e luleve në vazo brenda dhe jashtë	Sipas nevojës
15	Mbjellje, mirëmbajtje e luleve për ambientet e brendshme dhe jashtme	Dy herë në Vit

Shtojca 8.

TERMAT E REFERENCES

Objekti: “Shpenzime pastrimi, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera për zyra”

Objekti: “Shpenzime pastrimi, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera për zyra”

I. OBJEKTI I SHËRBIMIT PËR AMBIENTET E ZYRAVE QËNDRORE TË ALPEX SHA:

Ofrimi i shërbimit të pastrimit dhe të mirëmbajtjes të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të zyrave qendrore të ALPEX SHA që ndodhen në Rr. Liman Kaba, Rezidenca Olympic, Shkalla 3, Kati 1, Zyra 1, Tiranë.

Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme duhet të ofrohet duke vënë në dispozicion fuqinë punëtore, mjetet dhe materialet profesionale të pastrimit të Kontraktuesit sipas kërkesave në vijim:

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme dhe të jashtme janë si më poshtë:

1. Sipërfaqe pllakash 350 m².
2. Sipërfaqe xhamash 90 m².
3. Dyer të brendshme 16, dera e jashtme 1 copë.

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme:

Shërbime me frekuencë ditore.

- Pastrimi, larja e dyshemesë në të gjithë ambientin e brendshëm.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe hapësira të përbashkëta).
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.
- Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.
- Pastrimi i WC-ve, aksesorëve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër për duart dhe sapun i lëngshëm për larje duarsh)
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.
- Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobilieve brenda tyre.

Shërbime me frekuencë periodike.

- Pastrimi i ballkoneve, dyshemesë dhe parmakët (një herë në javë).
- Pastrimi i Arkivës (një herë në muaj).
- Pastrimi i xhamave brenda dhe jashtë (një herë në muaj).
- Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e ballkoneve dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, arkiva, salla e mbledhjeve, kuzhina, etj) (një herë në muaj).
- Pastrimi i ambientit në Dhomën e Serverit (një herë në muaj).
- Vadijtja, prashitja e luleve në vazo brenda dhe jashtë (sipas nevojës).
- Mbjellje, mirëmbajtje e luleve për ambientet e brendshme dhe të jashtme (dy herë në vit).

Tabelë përmbledhëse – Grafiku i kryerjes së shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme.

Nr.	Lloji i Shërbimit	Frekuenca e pastrimit
1	Pastrimi, larja e dyshemesë në të gjithë ambientin e brendshëm	Çdo ditë
2	Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe hapësira të përbashkëta).	Çdo ditë
3	Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.	Çdo ditë
4	Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.	Çdo ditë
5	Pastrimi i WC-ve, aksesoreve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
6	Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër për duart dhe sapun i lëngshëm për larje të duarve).	Çdo ditë
7	Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
8	Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobileve brenda tyre.	Çdo ditë
9	Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e ballkoneve dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, arkiva, salla mbledhjeve, kuzhina etj).	Një herë në muaj
10	Pastrimi i ballkoneve, dyshemenë dhe parmakët.	Një herë në javë
11	Pastrimi i Arkivës.	Një herë në muaj
12	Pastrimi i xhamave brenda dhe jashtë.	Një herë në muaj
13	Pastrimi i ambientit në Dhomën e Serverit.	Një herë në muaj
14	Vaditja, prashitja e luleve në vazo brenda dhe jashtë	Sipas nevojës
15	Mbjellje, mirëmbajtje e luleve për ambientet e brendshme dhe jashtme	Dy herë në Vit

**Përveç Shërbimeve sipas grafikut të mësipërm do të kryhen shërbime pastrimi të tjera, në kushte të jashtëzakonshme në funksion të mirëmbajtjes ditore të ambienteve të brendshme.*

Punonjësit e Shërbimit:

Kontraktuesi për kryerjen e Shërbimit duhet të ketë punonjësit e nevojshëm.

Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe mirëmbajtjen e luleve në ambientet e ALPEX SHA, Kontraktuesi duhet të vendosë në dispozicion të paktën 1 (një) punonjës pastrimi për çdo ditë.

Punonjësit e pastrimit, gjatë kohës së punës duhet të jenë të veshur me uniformën e Kontraktuesit, e cila duhet të jetë gjatë gjithë kohës e pastër dhe e rregullt.

Oraret e kryerjes së shërbimit:

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme do të kryhet nga dita e Hënë në të Premte, në 1 turn, me oraret si më poshtë:

a- Turni I: 08:00 – 16:00

Punonjësi, duhet të fokusohet në pastërtinë e zyrave, korridoreve, mobiljeve dhe pajisjeve në open space, ambienteve të përbashkëta dhe tualeteve (pastrimi i dyshemesë, zëvendësimi i qeseve të koshave të mbeturinave, letrave të duarve, letrave higjienike) etj., si edhe për mirëmbajtjen dhe pastrimin e Arkivës, dhomën e Serverit, Sallën e Mbledhjeve, Kuzhinën etj. Kontrollimi i pastërtisë së tualeteve duhet të bëhet periodikisht.

Të paktën 1 (një) herë në muaj duhet të kryhen pastrime me themel duke filluar me pastrimin e tualeteve, xhamave dhe më pas me larjen e dyshemesë së gjithë ambientit të brendshëm me makineri profesionale larëse - tharëse dyshemeje.

Materialet e pastrimit:

Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme, nga Kontraktori duhet të vihen në dispozicion materiale shumë cilësore, për shkak të vetë cilësisë së lartë të strukturës së brendshme. Ato nuk duhet të jenë gërryes dhe duhet të jenë në të njëjtën kohë pastrues dhe higjienizues. Kontraktori duhet të vejë në dispozicion (por pa u kufizuar në to) materiale të tilla si: qese mbeturinash, detergjent për pastrim dyshemeje (i cili duhet të jetë sipas llojit përkatës të dyshemesë), materialet e konsumit (letër higjienike, letër duarsh, sapun i lëngshëm për duart), lecka mikrofibër për marrjen e pluhurave, shtupa të posaçme për tualete, lecka për fshirje në të thatë, set për larjen e xhamave, karela pastrimi (nëse nevojitet), etj.

Detergjentet që duhet të vihen në dispozicion duhet të jenë të një cilësie të lartë, dhe duhet të kenë termat e referencës të përshkruara si vijon:

1	Solucion zbardhues dhe dezinfektues WC	litër
2	Solucion larës pllakash	litër
3	Solucion për larje xhamash	copë
4	Solucion/ Detergjent për pastrim mobiliesh	copë
5	Sapun i lëngshëm për larje duarsh	litër
6	Lecka mikrofiber	copë
7	Solucion me përmbajtje klori për larje dyshemeje	litër
8	Shtupa/lecka për larje	copë
9	Peceta të zakonshme pastrimi	copë
10	Qese mbeturinash 70x85 cm, 70 litra	pako
11	Qese mbeturinash 100x75 cm, 100 litra	pako
12	Kova plastike për larje	copë
13	Letra higjienike	pako
14	Letra duarsh	copë
15	Aromë ambienti me timer	copë
16	Mbajtëse letre për duar	copë
17	Mbajtëse sapuni i lëngshëm për duar	copë
18	Aromatik WC	Copë

1. Solucion zbardhues, që përdoret për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve, veshjeve porcelani, hidrosanitareve. Të heqë pikat e bardha të ujit. Të përdoret dhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim minimum nga 1-150 në 1-200 me ujë. Masat nga 1 litër deri në 10 litra. Të jene linjë profesionale.
2. Solucion për larje pllakash dyshemeje. Të jetë sa më i koncentruar (1-200 me ujë), të lëshojë aromë të lehtë pas larjes. Të jetë prodhim me standarde të EU dhe i certifikuar sipas standarteve. Të ketë kartat e sigurisë dhe të përbërjes. Masat nga 1 deri ne 10 litra. Të jenë linjë profesionale.
3. Solucion për larje xhamash (me spray). Të jetë prodhim me standardet e EU, dhe i certifikuar, të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Masa të jetë 500-800 ml me spray. Të jetë linjë profesionale.
4. Solucion/Detergjent për larje mobiliesh (me spray) 500 ml. Të certifikuara, të kenë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehte. Të jetë linje profesionale.

-
5. Sapun i lëngshëm për duart. Ambalazhimi të jetë në bidona nga 3 deri në 5 litra. Të jetë i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe të përbërjes. Të jete antibakterial, të ketë aromë të lehte.
 6. Peceta për pastrim pluhurash me mikrofibra (tip peshqiri) me përmasa 30x30.
 7. Solucion me përmbajtje klori për larje dyshemeje, të jetë paketim 1 litër.
 8. Tufa (shtupa) për larje dyshemeje, mikrofiber, 100% ekologjike të plota. Fijet të jenë në shirita me përmasa 25x4 cm +/- 2 cm, të mbushura plotë.
 9. Peceta të zakonshme pastrimi, set me 3 deri në 5 copë. Përmasa 18x20 cm, ngjyra të ndryshme, materiali sfungjer 100%. Fibër natyrale.
 10. Qese mbeturinash (qeset të jenë plastike, rezistente, me përmasa 70x85 cm, me kapacitet 70 litra dhe të jenë antibakteriale. Një pako të përmbajë 10 prerje.)
 11. Qese mbeturinash (qeset të jenë plastike, rezistente, me përmasa 100x75 cm, me kapacitet 100 litra dhe të jenë antibakteriale. Një pako të përmbajë 10 prerje.)
 12. Kova plastike për larje dyshemeje, me vend për shtrydhje shtupe. Të jenë shume rezistente dhe praktike. Të ketë të etiketuar në pamjen e jashtme shenjën e kujdesit, kapacitet 12-14 litra. Prodhim i verifikuar sipas standeve EU. Me përmasa 35x26x35 cm.
 13. Letër higjienike në paketa jo më pak se 10 rula. (3 shtresa, me këputje, 1 top me 135 ndarje.) Letra të ketë ngjyre të bardhë. Duhet që produktet të kenë certifikate kualiteti ku të përshkruhet që materiali është i padëmshëm për shëndetin e njeriut. Përmasat e një topi të jenë diametri 10 cm dhe lartësia 9,5 cm.
 14. Letër për fshirje duarsh, 2 shtresa, ngjyrë e bardhë, që vendosen në aparatet e tyre, me paketim jo më pak se 270 fije, me përmasa 21x22 cm, të jetë cilësore. Produkti duhet të jetë i pajisur me certifikate kualiteti ku të përshkruhet që është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.
 15. Aromatizues ambientesh me timer (për zyra). Të jetë në formë spray. Me timer. Aromatik, 250-300ml.
 16. Dispensera letra duarsh zig-zag, të kenë përmasa 270 mm x 410 mm x 140 mm, të jenë cilësi e larte.
 17. Mbajtëse sapuni i lëngshëm për duart, që vendoset në mur.
 18. Aromatik WC-je (pllaka, pileta, hidrosanitare). Paketim 1 litër.

Furnizimi me materiale pastrimi duhet të bëhet sipas një itinerari të caktuar apo sipas nevojave dhe konsumimit, në mënyrë që mos të mungojë asnjëherë furnizimi.

Tualetet e brendshme janë si më poshtë:

- Para tualete 2 copë.
- Tualete 5 copë.

Kontraktuesi duhet të bëjë furnizimin me materiale e detergjente pastrimi dhe mirëmbajtje duke pasur parasysh ambientet e mësipërme dhe numri i stafit përafërsisht 20 (njëzetë) persona.

Pastrimi i dyshemesë: Duke qenë se dyshemeja është me përbërje gres prej porcelani (gres porcenallato), edhe mënyra e pastrimit të saj duhet të bëhet në varësi të llojit të dyshemesë. Më poshtë po paraqesim një përshkrim të materialit të pllakave të dyshemesë:

Gres porcellanato është bërë nga një përzierje kuarci, argjila, okside të kalcinuara, feldspar. Materiali që rezulton në një bazë të lehtë dallohet nga uniformiteti ose grimcimi i modelit. Përzierja është e njëtrajtshme dhe e ngjeshur. Forca e materialit të ardhshëm varet nga lartësia e presionit. Nën shtypje të larte në gresin prej porcelani, zbrazëtirat, zgavrat eliminohen, gjë që çon në formimin e një materiali të dendur dhe shumë të qëndrueshëm. Në temperatura të larta, pllakat e shtypura që rezultojnë ndizen. Kjo ju lejon të krijoni një monolit nga pllaka që është tepër rezistent ndaj ndikimeve të jashtme. Pllakat gres janë gjithashtu të qëndrueshme, rezistencë ndaj gërryerjes, ngricës dhe të ftohtit.

Të gjithë detergjentet për pastrimin e dyshemeve të mësipërme duhet të jenë një cilësi të lartë. Në rast të kundërt, ato nuk do të lejohen të përdoren dhe do të kthehen mbrapsht.

Për kryerjen e këtyre shërbimeve nevojiten makineritë si më poshtë vijon:

-
- * Makina profesionale larëse tharëse e dyshemesë (një herë në muaj):
 - * Makina larëse e dyshemesë është një element shumë i rëndësishëm i mirë organizimit dhe mbarëvajtjes së pastrimit të ambienteve të brendshme. Ajo duhet të jetë e një cilësie shumë të mirë, për të shmangur çdo dëmtim apo gërvishtje të dyshemesë me përbërje gres prej porcelani.
 - * Punonjësi i cili do të kryejë shërbimin e larjes së dyshemeve me makineri profesionale duhet ta përdorë shumë mirë makinerinë.
 - * Shkallë për përdorim në ambientet e brendshme për pastrimet në lartësi.

Makineritë profesionale për ofrimin e shërbimit të pastrimit:

- *Makineri larëse tharëse e dyshemesë – 1 cope*
- *Makineri thithëse pluhurash dhe lëngjesh – 1 cope*

Shërbimi që kërkohet: Shpenzime pastrimi, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera për zyra, për 12 muaj.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: *Ne ambientet e zyrave te ALPEX SHA: Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic, Shkalla 3, Kati 1, Zyra nr.1, Tiranë.*

Shenim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas pikës 1 të kësaj Shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Në përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro minimale vjetore, në një vlerë të paktën prej 600,000.00 (gjashtëqind mijë) Lekë pa TVSH, gjatë tre viteve të fundit financiare.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse OE ofertues arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si provë për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarates të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 300,000.00 (treqind mijë) Lekë pa TVSH.

- Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave/sherbimeve të furnizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar vjetor i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 5 punonjës.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar, shoqëruar me listëpagesat përkatëse E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Shenim: Në plotësimin e “Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit”, në pikën B “Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, OE ofertues duhet të shënojë në mënyrë të saktë, kualifikimet përkatëse të punonjësve. Këto deklaramë do të shqyrtohen kur OE ofertues do të paraqesë dokumentet origjinale ose kopje të noterizuara për punonjësit, para shpalljes fituese të ofertës. Keqinformimi dhe dorëzimi i dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, sanksionohet nga pika 1/ e nenit 78 “Përfundimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatën përkatëse të vlefshme ISO, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, që ka lidhje me objektin e prokurimit.

2.3.4 Për detergjentët dhe produktet e kerkuara si më poshtë duhet të paraqitet Skeda Teknike e tyre:

1	Solucion zbardhues dhe dezinfektues WC	litër
---	--	-------

2	Solucion larës pllakash	litër
3	Solucion për larje xhamash	copë
4	Solucion/ Detergjent për pastrim mobiliesh	copë
5	Sapun i lëngshëm për larje duarsh	litër
6	Solucion me përmbajtje klori për larje dysHEMEJE	litër

2.3.5 *Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qira makineritë, sipas Termave të Referencës, të nevojshme për kryerjen e shërbimit të kërkuar mjetet si vijon:*

- *Makineri larëse tharëse të dyshemesë – 1 copë*
- *Makineri thithese pluhrash dhe lëngjesh – 1 copë*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë gjithë dokumentacionin e rregullt:

- Për makinëritë– fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi, katalogët teknikë, si dhe foto. Në rastin kur është me qira, duhet të disponojë dokumentacionin e sipërcituar dhe kontratën e qirasë.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.6 *Në funksion të plotësimit të Shtojces 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p>

etj.

